

Nr. Prot. 095/B/25

VENDIM Nr. 2601

Për miratimin e dokumentit

“Plani i shpërndarjes dhe shfrytëzimit të brezit të frekuencave 24.25 -27.5 GHz për rrjetat e komunikimit të lëvizshëm & fiks (MFCN)”

Në mbështetjen të nenit 3 paragrafi 1) dhe 2), nenit 9 paragrafi 3.6), nenit 10 paragrafët 11) dhe 12), nenit 45 paragrafi 1) dhe paragrafi 2), neni 54 paragrafët 1) dhe 2) nenit 79 paragrafët 1) dhe 2) të Ligjit për Komunikime Elektronike Nr. 04/L-109 (tutje referuar si – Ligji ose LKE), si dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare Ref. Nr. Prot 054/B/17 (tutje referuar si – Autoriteti ose ARKEP), Bordi i Autoritetit në përbërje nga:

- | | |
|------------------------------|----------|
| 1. z. Nazim Rahimi | Kryetar, |
| 2. znj. Lule Ahmed | Anëtare, |
| 3. znj. Rezarta Duraku-Rizaj | Anëtare, |
| 4. z. Arijan Qorolli | Anëtar. |

në mbledhjen e 56-të, me radhë, të mbajtur me datë; 16 Shtator 2025, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga Departamenti për Menaxhimin e Frekuencave (DMF), nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Miratohet dokumenti ‘Plani i shpërndarjes dhe shfrytëzimit të brezit të frekuencave 24.25 -27.5 GHz për rrjetat e komunikimit të lëvizshëm & fiks (MFCN)’.
- II. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Plani i shpërndarjes dhe shfrytëzimit të brezit të frekuencave 24.25 -27.5 GHz për rrjetat e komunikimit të lëvizshëm & fiks (MFCN) përcakton shpërndarjen e brezit të frekuencave 24.25 -27.5 GHz (“brezi 26 GHz”) për shërbimin e lëvizshëm të radio komunikimit, ndarjen e brezit në radio kanale të frekuencave, detajet e hollësishme teknike, mënyrën e shfrytëzimit, si dhe

mënyrën e dhënies së radio frekuencave për Rrjetat e Komunikimit të Lëvizshëm/Fiks MFCN (Mobile/Fixed Communications Networks), sipas Planit të përdorimit të Radio frekuencave.

Ligji i Komunikimeve Elektronike, respektivisht neni 10 (Kompetencat e Autoritetit) paragrafi 12 përcakton kompetencat e Autoritetit për menaxhimin e resurseve të fundme – spektrin e radio frekuencave.

Neni 45 paragrafi 2 i Ligjit përcakton që: Autoriteti, Spektri frekuencor (kanalet) do të menaxhohet duke u bazuar në Planin Kombëtar të Radio - frekuencave dhe Planin për përdorimin e radio-frekuencave (kanaleve) konform planeve zhvillimore për radio komunikime.

Neni 54, paragrafi 2) i Ligjit përcakton se ARKEP vendos kushtet për shfrytëzimin e radio frekuencave.

Në përputhje me nenin 82, të Ligjit, dokumenti para aprovimit ka kaluar në procedurën e konsultimit publik, duke ua ofruar mundësinë palëve të interesit që në afat të arsyeshëm kohor të shprehin pikëpamjet e tyre.

Andaj, duke pasur parasysh atë që u tha më lart, Bordi i Autoritetit ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit.

Prishtinë, 22/09/2025.

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Nazim Rahimi
Kryetar i Bordit

Aktvendimi i dërgohet:

- Departamentit për Menaxhimin e Frekuencave (DMF) ;
- Departamentit Ligjor (DL) ARKEP;
- Arkivës së ARKEP